



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1170 Prot.

Tiranë, më 2.9 2019

VENDIM Nr. 202, datë 29.08.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10, datë 29.08.2019, pasi shqyrtoi konceptin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit **"GODINË POLIFUNKSIONALE 3-4-6 KATE ME 2 KATE NËNTOKË"**, rruga "Egnatia", zona arkeologjike "B", Durrës – subjekti "KASTRATI" sh.p.k, dhe paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Luan Përzhita

VENDOSI:

1. Të miratojë konceptin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit **"GODINË POLIFUNKSIONALE 3-4-6 KATE ME 2 KATE NËNTOKË"**, rruga "Egnatia", zona arkeologjike "B", Durrës – subjekti "KASTRATI" sh.p.k, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Luan Përzhita.
2. Subjekti "KASTRATI" sh.p.k duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjektin e licencuar në arkeologji Z. Luan Përzhita, i cili duhet të kryejë sondazhet arkeologjike për projektin e sipërcituar, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Raporti me rezultatet e sondazheve arkeologjike të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në mbledhjen e radhës së KKA.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al